

Tabelat e Burim-Përdorimeve dhe Input-Output

Viti 2013

Tiranë, më 14 Tetor 2016: INSTAT publikon për përdoruesit tabelat e konsoliduara të Burim-Përdorimeve (TBP) dhe tabelën e derivuar Input-Output (TIO) për vitin 2013 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2) dhe Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008). Përpilimi i tabelave është bërë duke u mbështetur në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe në Manualin e tabelave Burime – Përdorime.

Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve

Tabelat e Burim-Përdorimeve ofrojnë një pamje të detajuar të ekonomisë dhe janë një instrument shumë i fuqishëm në analizën dhe krijimin e modeleve statistikore në mënyrë që të mund të analizojmë lidhjet midis kërkesës finale dhe prodhimit të industrive. Përpilimi dhe balancimi i këtyre tabelave bëhet në nivel të detajuar A88 industri sipas NVE Rev.2 dhe P88 produkte sipas NP 2008, ndërsa publikimi bëhet në nivel A35 industri dhe P35 produkte për të qënë në përputhje me treguesit e tjerë të llogarive kombëtare.

Qëllimi parësor i TBP-ve është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të llogarive kombëtare, duke siguruar një strukturë të kontrollit të konsistencës dhe plotësisë së të dhënave. Procesi i përpilimit të TBP-ve është shumë kompleks dhe kërkon jo vetëm një numër të madh burimesh të dhënash por dhe informacion tepër të detajuar në nivel produkti.

Gjithashtu, sistemi i TBP-ve është një instrument shumë i rëndësishëm për analizat makroekonomike, pasi vlerëson agregatët kryesorë makroekonomik si PBB, vlera e shtuar, prodhimi sipas industrive, importi, konsumi final, formimi bruto i kapitalit, eksporti etj.

Në tabelën 1, paraqitet në mënyrë të agreguar tabela e burimeve dhe përdorimeve për vitin 2013.

Tab. 1 Tabela e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente për vitin 2013, në milion lekë

Aktivitetet (NVE)	Bujqësia	Industria	Shërbime	Totali i prodhimit sipas produkteve	Importet (CIF)	MTT*	Totali i Burimeve	Bujqësia	Industria	Shërbime	Totali i konsumit ndërmjetës sipas produkteve	KF*	Totali i Përdorimeve
Produkte (NP)	1	2	3	4=1+2+3	5	6	7=4+5+6	8	9	10	11=8+9+10	12	13=10+12
Bujqësia [1-3]	267.721		16	267.737	22.570	58.474	348.781	81.809	18.459	11.351	111.619	237.162	348.781
Industria [5-43]	100.524	818.435	3.471	922.430	399.203	372.080	1.693.713	20.531	461.386	197.757	679.674	1.014.039	1.693.713
Shërbimet [45-98]	1.292	43.949	1.010.871	1.056.113	212.176	- 258.199	1.010.090	3.056	71.199	203.033	277.288	732.802	1.010.090
Totali	369.537	862.384	1.014.359	2.246.280	633.950	172.355	3.052.584	105.397	551.044	412.141	1.068.582	1.984.003	3.052.584
Vlera e Shtuar								264.140	311.340	602.218	1.177.698		

* Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

** Komponentët e kërkesës finale

Tabela e Burimeve

Kjo tabelë ofron një vlerësim për burimet e të mirave dhe shërbimeve të prodhuara në vendin tonë dhe atyre të importuara. Sipas rreshtave paraqiten burimet e produkteve ndërsa sipas kolonave aktivitetet ekonomike që i prodhojnë këto produkte. Klasifikimi i çdo njësie ekonomike bazohet në produktin që zë pjesën më të madhe të prodhimit të saj.

Vlerat e prodhimit vendas dhe importit janë paraqitur fillimisht me çmime bazë, më pas transformohen me çmime tregu, ku për çdo produkt janë shtuar taksat neto mbi produktet dhe marzhet e tregtisë dhe transportit. Ky transformim bëhet pasi burimet duhet të jenë të balancuara me përdorimet me të njëjtin sistem vlerësimi, me çmime tregu.


Në tabelën 2, paraqitet në mënyrë të agreguar tabela e burimeve për vitin 2013.

Tab. 2 Tabela e Burimeve për vitin 2013, në milion lekë

Aktivitetet(NVE)	Bujqësia	Industria	Shërbime	Totali i prodhimit sipas produkteve	Importet (CIF)	Marzhi i tregtisë dhe transportit	Taksat minus subvencione mbi produktet	Totali i burimeve me çmime tregu
Produkte (NP)	1	2	3	4=1+2+3	5	6	7	8=4+5+6+7
Bujqësia [1-3]	267.721		16	267.737	22.570	52.193	6.281	348.781
Industria [5-43]	100.524	818.435	3.471	922.430	399.203	213.885	158.194	1.693.713
Shërbimet [45-98]	1.292	43.949	1.010.871	1.056.113	212.176	- 266.078	7.879	1.010.090
Totali	369.537	862.384	1.014.359	2.246.280	633.950		172.355	3.052.584


Gjatë vitit 2013, struktura e tabelës së burimeve të të mirave dhe shërbimeve të disponueshme nga përdoruesit brenda dhe jashtë territorit të vendit (Fig.1), paraqitet e tillë: prodhimi vendas përfaqëson 73,59 % të burimeve gjithsej në territorin e brendshëm me çmimet e blerjes. Importet përbëjnë 20,77 %, ndërsa 5,65 % ka qenë pjesa e taksave neto (taksa minus subvencionet mbi produktet). Në vitin 2013 totali i burimeve me çmime korrente shënoi një rënie prej 0,32 % krahasuar me vitin 2012, ndikuar nga rënia e importeve prej 8,51 % në terma nominal.

Fig. 1 Struktura e Burimeve, në %



Përsa i përket komponentëve të tabelës së burimeve sipas të mirave dhe shërbimeve (Fig.2), në prodhimin vendas të mirat zënë 52,98 % të totalit, ndërsa shërbimet zënë 47,02%. Në importet të mirat zënë 66,53 % të totalit, ndërsa shërbimet zënë 33,47%.

Fig. 2 Struktura e Burimeve sipas produkteve, në %



Në tabelën e mëposhtme (Tab.3), paraqiten burimet totale me çmime bazë për vitin 2013 dhe origjina e tyre nëse janë prodhim vendas apo të importuara.

Tab. 3 Struktura e Burimeve sipas origjinës në milion lekë dhe në %

Produktet (NP)	Prodhim vendas		Import	
	mln	%	mln	%
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	267.737	11,92	22.570	3,56
Industria [5-39]	560.924	24,97	398.795	62,91
Ndërtimi [41-43]	361.506	16,09	408	0,06
Tregtia; transporti; shërbime të akomodimit dhe shërbimit ushqimor [45-56]	402.080	17,90	112.162	17,69
Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	107.774	4,80	25.107	3,96
Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	53.956	2,40	5.634	0,89
Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	116.530	5,19		0,00
Shërbime shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse [69.1-82]	125.519	5,59	20.457	3,23
Administrata publike;Arsimi; Shëndetësia dhe shërbime të punës sociale [84-88]	197.220	8,78	18.938	2,99
Arte, argëtim dhe çlodhje; Shërbime të tjera [90-98]	53.033	2,36	29.878	4,71
Totali i burimeve me çmime bazë	2.246.280	100,00	633.950	100,00

Peshën më të madhe në strukturën e prodhimit vendas me çmime bazë për vitin 2013 në nivel të agreguar 10 grup-produkte NP e zënë produktet e *Industrisë* me 24,97 %, pasuar nga *Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor* me 17,90 % dhe *Ndërtimi* me 16,09 %. Në strukturën e produkteve të importuara përsëri peshën më të madhe e zënë produktet e *Industrisë* me 62,91% ndjekur nga *Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor* me 17,69 %.

Tabela e Përdorimeve

Në tabelën e përdorimeve paraqiten drejtimet kryesore të përdorimit të burimeve të formuara në ekonominë e vendit. Ato paraqiten në formën e përdorimit si Konsum Ndërmjetës, Konsum Final i Familjeve, Konsum Final i Administratës Publike, Formimi bruto i Kapitalit dhe Eksporte. Kjo tabelë paraqet në kolona strukturën e inpueteve për çdo degë të aktivitetit ekonomik dhe sipas rreshtave përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme.

Në tabelën 4, paraqitet në mënyrë të agreguar tabela e përdorimeve për vitin 2013.


Tab. 4 Tabela e Përdorimeve për vitin 2013, në milion lekë

Aktivite (NVE)	Bujqësia	Industria	Shërbime	Totali i konsumit ndërmjetës sipas produkteve	Eksportet (FOB)	Konsumi Final i Familjeve dhe Administratës Publike	Formimi Bruto i Kapitalit Fiks dhe Ndryshimi i Gjendjeve	Totali i Përdorimeve me çmime tregu
Produkte (NP)	1	2	3	4=1+2+3	5	6	7	8=4+5+6+7
Bujqësia [1-3]	81.809	18.459	11.351	111.619	7.451	219.965	9.745	348.781
Industria [5-43]	20.531	461.386	197.757	679.674	163.245	480.913	369.880	1.693.713
Shërbimet [45-98]	3.056	71.199	203.033	277.288	217.278	502.861	12.664	1.010.090
Total i konsumit ndërmjetës sipas produkteve	105.397	551.044	412.141	1.068.582	387.975	1.203.739	392.289	3.052.584
Vlera e Shtuar	264.140	311.340	602.218	1.177.698				

Gjatë vitit 2013, struktura e tabelës së përdorimit të të mirave dhe shërbimeve të disponueshme nga përdoruesit brenda dhe jashtë territorit të vendit (Fig.3), paraqitet e tillë: 35,01 % është përdorur për konsum ndërmjetës në proceset e prodhimit, 39,43 % është përdorur për konsum final nga familjet dhe administrata publike, 12,85 % është përdorur për formim bruto të kapitalit dhe 12,71 % është eksportuar.


Ashtu siç vihet re në figurën 3, në vitin 2013 nuk ka ndryshime thelbësore në strukturën e përdorimeve krahasuar me vitin 2012.

Fig. 3 Struktura e Tabelës së Përdorimeve, në %



Përsa i përket strukturës së produkteve në tabelën e përdorimeve (Fig. 4), të mirat përfaqësojnë 66,91 % të totalit kurse shërbimet 33,09 %. Ndërkohë që përdorimi i të mirave kryeson në zërat e formimit bruto të kapitalit me 96,77 % dhe konsumit ndërmjetës me 74,05 %, pesha e tyre vjen duke u zvogëluar në zërin e konsumit final në 58,23 %, ndërsa në eksporte shërbimet kryesojnë me 56,00 % kundrejt 44,00 % të të mirave.

Fig. 4 Struktura e Përdorimeve sipas produkteve, në %



Në tabelën e mëposhtme (Tab.5), paraqiten përdorimet totale me çmime tregu për vitin 2013 dhe destinacioni i tyre nëse janë për përdorim të brendshëm apo për eksport.

Tab. 5 Struktura e Përdorimeve sipas destinacionit në milion lekë dhe në %

Produktet (NP)	Përdorim vendas		Eksport	
	mln	%	mln	%
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	341.330	12,81	7.451	1,92
Industria [5-39]	1.166.310	43,77	161.585	41,65
Ndërtimi [41-43]	364.157	13,67	1.660	0,43
Tregtia; transporti; shërbime të akomodimit dhe shërbimit ushqimor [45-56]	141.434	5,31	104.893	27,04
Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	88.851	3,33	48.188	12,42
Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	52.779	1,98	7.121	1,84
Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	116.611	4,38		0,00
Shërbime shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse [69.1-82]	120.366	4,52	26.741	6,89
Administrata publike;Arsimi; Shëndetësia dhe shërbime të punës sociale [84-88]	208.632	7,83	7.657	1,97
Arte, argëtim dhe çlodhje; Shërbime të tjera[90-98]	64.140	2,41	22.678	5,85
Totali i përdorimeve me çmime tregu	2.664.610	100,00	387.975	100,00

Peshën më të madhe në strukturën e përdorimeve vendase me çmime tregu (ku përfshihen për konsum të ndërmjetëm, konsum final të familjeve dhe administratës publike, formim bruto të kapitalit fikse dhe ndryshim gjendje) për vitin 2013, në nivel të agreguar 10 grup-produkte NP, e zënë produktet e *Industrisë* me 43,77 %, pasuar nga *Ndërtimi* me 13,67 % dhe *Bujqësia, pyjet dhe peshkimi* me 12,81 %. Në strukturën e produkteve të eksportuara përsëri peshën më të madhe e zënë produktet e *Industrisë* me 41,65 % ndjekur nga *Tregtia; transporti; shërbime të akomodimit dhe shërbimit ushqimor* me 27,04 %.

Tabelat Input - Output

Tabelat e konsoliduara të TBP-ve janë baza nga derivohen tabelat simetrike Input-Output (TIO). Mbështetur në supozimin e teknologjisë fikse dhe strukturës fikse të shitjeve përftojmë tabelat *produkt x produkt* ose *industri x industri*. TIO është derivim i tabelës së përdorimeve duke kaluar në industri homogjene. Për vitin 2013 ndërtimi i tabelave IO është mbështetur mbi supozimin e strukturës së shitjeve fikse për produktin, ku secili produkt ka strukturën e vetë të shitjeve pavarësisht nga industria në të cilën prodhohen. Në tabelën e mëposhtme (Tab.6), është paraqitur tabela e Input-Outputit *industri x industri* për vitin 2013, me çmime bazë.

Tab. 6 Tabela Input - Output për vitin 2013, në milion lekë

Aktivitete (NVE)	Bujqësia	Industria	Shërbime	Totali i konsumit ndërmjetës me çmime bazë	KF**	Totali i Përdorimeve me çmime bazë
Aktivitete (NVE)	1	2	3	4=1+2+3	5	6
Bujqësia [1-3]	71.248	20.056	17.743	109.047	326.827	435.873
Industria [5-43]	12.008	367.580	133.767	513.355	710.456	1.223.812
Shërbimet [45-98]	23.433	102.196	215.714	341.343	879.202	1.220.545
Totali i konsumit ndërmjetës sipas industrive	106.688	489.831	367.225	963.745	1.916.485	2.880.230
Vlera e Shtuar me çmime bazë	262.849	372.553	647.134	1.282.535		
Prodhimi me çmime bazë	369.537	862.384	1.014.359	2.246.280		
Importet (CIF)	66.336	361.427	206.186	633.950		
Burimet me çmime bazë	435.873	1.223.812	1.220.545	2.880.230		

Informacion për përdoruesin

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e TBP-ve mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Ndërtimi i TBP-ve kërkon që të mbliidhen një numër i madh të dhënash në një nivel shumë të detajuar. Burimet e informacionit që përdoren në këtë sistem janë nga më të larmishmet dhe në shumë raste mund të jenë edhe dytësore por që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në balancimin e qarkullimit të produkteve. Për më tepër lidhur me metodologjinë e përpilimit të TBP dhe TIO referojuni adresës së mëposhtme: <http://www.instat.gov.al/al/publications/librat/2015/tabela-e-burim-p%C3%ABrdorimeve,-2009-2011.aspx>

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë: - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE Rev.2). - Nomenklatura e produkteve (NP 2008); - Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP); - Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

Burimet

Për vlerësimet e TBP-ve përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore etj. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruara nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa të Statistikave të Çmimeve, Statistika të bujqësisë dhe mjedisit, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të administratës publike; Statistika të tregtisë së jashtme; Libri i shitjeve dhe i blerjeve etj.

Procesi i Balancimit

Procesi i balancimit është një proces shumë i rëndësishëm në tabelat e burim - përdorimeve. Pasi është bërë një përpunim i detajuar për secilin komponent duhet që gjithë burimet e një vendi të shkojnë si përdorime nga ana tjetër. Në shumicën e rasteve kjo mund të mos arrihet që në hapin e parë të përdorimit të informacionit për këtë qëllim analiza zhvillohet mbi çdo produkt në këtë sistem.

Përpara se të shikohet mospërputhja në nivel produkti analizohet mospërputhja statistikore që ekziston ndërmjet metodave të ndryshme të vlerësimit të PBB-së. Në sistemin e tabelave të burim-përdorimeve kjo mospërputhje statistikore eliminohet e si rrjedhim kërkohet që të arrihet ky balancim makroekonomik.

Në rastet kur diferenca ndërmjet burimeve dhe përdorimeve është më e vogël se 5 % përdoret një balancim automatik i mbështetur mbi shpërndarjen në formë raporti të diferencës ekzistuese. Kur kjo diferencë është ndërmjet 5% dhe 10% mund të mbështetemi mbi një analizë dhe balancim manual të diferencave. Në rastet kur kjo diferencë është më e madhe se 10 % atëherë jemi në një situatë e cila kërkon trajtim në burimin bazë të informacionit. Në këto raste shikohen të gjitha të dhënat nga kanë ardhur vlerësimet për të kuptuar fenomenin që ka ndodhur dhe për të përcaktuar sa më saktë arsyen e diferencave. Në këto raste mund të jetë e nevojshme që komponent të ndryshëm të burimeve apo përdorimeve të kërkojnë një rivlerësim i cili do të sillte një cikël rrethor të vlerësimeve. Ky cikël do të vazhdojë derisa të gjitha diferencat të jenë brenda intervaleve të pranueshme duke na mundësuar një konsistencë të plotë të vlerësimeve të PBB-së me metoda të ndryshme.

Përkufizime

Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente: Sistemi i TBP-ve me çmime korrente në Shqipëri është i ndërtuar në një nivel prej 88 produktesh dhe 88 aktiviteteve që korrespondojnë me NVE rev. 2 dy shifrore. Analizat janë zhvilluar në nivel produkti sipas klasifikimit NP 2008 2, 4 dhe 6 shifrore duke mundësuar në këtë mënyrë një pamje të qartë të qarkullimit të produktit në ekonomi. Për ndërtimin e TBP-ve në Shqipëri janë kryer një sërë analizash dhe studimesh për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve administrative dhe statistikore. Fokus i veçantë i është vënë kryesisht nivelit të detajimit të të dhënave për të kaluar në një detajim sa më të madh të mundshëm.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte të shërbimeve për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim.

Konsumi ndërmjetës: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fikse.

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njërive institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo Fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (IJFSHs).

Konsumi final i familjeve: Llogaritet të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregëtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHs dhe vlerës së prodhimit tregtar.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).

Importi i të mirave dhe shërbimeve konsiston në vlerën e transaksioneve në të mira dhe shërbime të rezidentëve me jo-rezidentët.

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve: Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysmë të gatshme, mallra, kafshë, etj.

Marzhi Tregtar përcaktohet si diferencë midis çmimit aktual ose të imputuar të një produkti të blerë për rishitje, dhe çmimit që do të paguhej për zëvendësimin e produktit në momentin e shitjes.

Marzhi i Transportit përfshin koston e transportit të paguar më vete nga blerësi të përfshira në përdorimet me çmime të blerësit por jo në prodhimin e prodhuesit me çmime bazë apo në marzhin tregtar

Çmime bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të fatuara më vete.

Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime korrente: Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.